REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1986 Prot. Tiranë, më 28. 3. 2022

URDHËR

Nr. 157, datë 28. 3 .2022

PËR
MIRATIMIN E KARTËS SË PERFORMANCËS SË SHKOLLËS DHE UDHËZUESIT TË SAJ

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 11, të nenit 6 dhe të nenit 26 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Kartës së Performancës së Shkollës dhe të udhëzuesit të saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Urdhri nr. 477, datë 06.12.2014 i ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për miratimin e "Kartës së Performancës së Shkollës" dhe të "Udhëzuesit për Kartën e Performancës së Shkollës"", shfuqizohet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Evis KUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KARTA E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS DHE UDHËZUESI I SAJ

Tiranë, 2021

HYRJE

Karta e Performancës së Shkollës (në vijim KPSh) është përdorur që prej vitit 2014 për renditjen e shkollave në nivel rajonal. KPSh-ja ka ndërlidhur transparencën me llogaridhënien, duke ofruar të dhëna për arritjet e shkollës gjatë një viti shkollor.

Mbështetur në ndryshimet e akteve ligjore në sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë pas vitit 2014, zbatimin e kurrikulës me kompetenca në sistemin parauniversitar, ristrukturimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026, u konsiderua i nevojshëm edhe rishikimi i treguesve të Kartës së Performancës së Shkollës.

Nga sa më lart u realizua vlerësimi për periudhën 5-vjeçare mbi zbatimin e procesit të KPSh-së në institucionet arsimore parauniversitare të vendit, si dhe u rivlerësuan treguesit për të mundësuar vijimësinë e zbatimit të Kartës së Performancës, nga të gjitha shkollat e vendit.

Për t'iu ardhur në ndihmë drejtuesve të shkollave dhe ZVAP-ve dhe për ta pasur sa më të lehtë dhe të saktë përllogaritjen e secilit tregues, në këtë udhëzues janë shpjeguar hollësisht mënyra e llogaritjes së treguesve, shoqëruar me tabelat në Excel.

Udhëzuesi për KPSh-në përcakton gjithashtu, detyrat që ka secili institucion përgjegjës për arsimin parauniversitar, në varësi të MAS-it.

I. Dobia e Kartës së Performancës së Shkollës

Karta e Performancës së Shkollës ofron të dhëna për arritjet e shkollës gjatë një viti shkollor, për një krahasim në nivel vendor mbështetur në tregues cilësorë dhe sasiorë.

Ajo shërben për të informuar prindërit, drejtuesit, mësuesit, nxënësit, institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe aktorë të tjerë të interesuar për jetën e shkollës, të analizojnë dhe të krahasojnë rezultatet e shkollës për tregues të ndryshëm të arritjeve.

KPSh-ja u bën të qartë prindërve pikat e forta dhe të dobëta të shkollës ku fëmija e tyre mëson ose do të mësojë dhe nëpërmjet saj, ata e kanë më të mundur të kërkojnë përmirësime të caktuara në arritjet e shkollës dhe të japin ndihmesën e tyre për këto përmirësime.

Të dhënat e KPSh-së ndihmojnë drejtuesit dhe mësuesit e shkollës, që të identifikojnë aspektet që kanë nevojë për më shumë vëmendje, për t'i përfshirë në planet e tyre të përmirësimit.

Institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar nëpërmjet të dhënave të KPSh-së, kanë një "hartë" të hollësishme të arritjeve dhe të mosarritjeve të shkollave në juridiksionin e tyre, për të identifikuar shkollat që kanë arritje të larta për tregues të veçantë ose në përgjithësi dhe për të përhapur përvojat e tyre të suksesshme, ndërsa për shkollat me arritje të ulëta, për të gjithë treguesit ose tregues të veçantë, t'i ndihmojnë për t'u përmirësuar.

KPSh-ja bëhet publike për nxënësit, prindërit, personelin e shkollës dhe për komunitetin e saj.

II. Grupimi i shkollave për renditjen e tyre

KPSh-ja plotësohet nga të gjitha shkollat publike dhe ato private[1].

Shkollat renditen veç për arsimin bazë dhe veç për arsimin e mesëm të lartë.

Renditja e shkollave bëhet në nivel vendor nga Zyra Vendore e Arsimit Paruniversitar (ZVAP).

III. Treguesit e Kartës

Udhëzuesi i KPSh-së përshkruan treguesit qendrorë të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Treguesit janë të njëjtë për të gjitha shkollat. Lista e treguesve qendrorë mund të ndryshojë vetëm nga MAS-i, sipas përparësive që ka. Çdo ndryshim të treguesve qendrorë, pasqyrohet në udhëzimin e fillimit të vitit shkollor. Në treguesit qendrorë përfshihen edhe pyetje nga pyetësorët.

Llojet e treguesve janë:

a) Tregues të dhënat e të cilëve llogariten nga shkollat.
b) Tregues të pyetësorëve me nxënës, prindër dhe mësues, të cilët përpunohen nga ZVAP-të;
c) Tregues të ndryshimeve të dy viteve të njëpasnjëshme (ose krahasuese).

Drejtori i shkollës ka përgjegjësinë, që në fund të çdo viti mësimor, të plotësojë të gjithë treguesit e përcaktuar (përveç pyetësorëve) dhe t'i dërgojë zyrtarisht në ZVAP-në përkatëse.

Të dhënat e treguesve llogariten për vitin e kaluar shkollor. Të dhënat e treguesve llogariten nga drejtori ose nga një nëndrejtor i saj.

Rezultatet e treguesve rrumbullakosen me dy shifra pas presjes dhjetore.
ZVAP-të mund të shtojnë tregues të tjerë, në varësi të përparësive që kanë.

A. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË KARTËS

Të dhënat e përgjithshme të shkollës, të cilat paraqiten në KPSH janë:

- Emri i shkollës;
- ZVAP-ja ku bën pjesë shkolla;
- Adresa e shkollës;
- Adresa elektronike e shkollës;
- Numri i nxënësve të shkollës;
- Numri i mësuesve të shkollës;
- Numri i drejtuesve të shkollës;
- Objektivi (objektivat) e planit vjetor aktual të shkollës;
- Kalueshmëria dhe arritjet vjetore për tri vitet e fundit;
- Vlerësimi i jashtëm i shkollës, për atë vit shkollor, nëse shkolla është vlerësuar;

[1] Karta e Performancës së Shkollës nuk plotësohet nga shkollat profesionale.

- Vlerësimi i brendshëm i shkollës, për atë vit shkollor;
- Renditja e shkollës në nivel vendor, sipas KPSh-së së fundit.

Drejtoria e shkollës, pas konsultimit me këshillin e mësuesve, mund të vendosë për të dhëna të tjera të shkollës, si:

- të ardhurat financiare të siguruara prej saj;
- lëndë të veçanta me zgjedhje që ofron;
- çmimet që ka fituar shkolla gjatë tri viteve të fundit;
- karakteristikat sociale dhe demografike të shkollës (2-3 më të rëndësishmet);
- raporti nxënës/mësues;
- përqindja e mësuesve me titullin "Mësues mjeshtër";
- laboratorë funksionalë;
- etj.

I. TREGUESIT E ARSIMIT BAZË/ARSIMIT TË MESËM

1. Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla, kundrejt nxënësve të regjistruar[2] në fillim të vitit shkollor.

Nxënësit e larguar janë ata që nuk vijojnë mësimet në një shkollë tjetër (nuk përfshihen nxënësit e transferuar). Në arsimin bazë janë nxënësit braktisës, ndërsa në AML janë nxënësit e larguar, që nuk vijojnë mësimet në një shkollë tjetër (në shkolla brenda dhe jashtë vendit).
Nuk përfshihen në llogaritje, nxënësit e ardhur në shkollë gjatë vitit shkollor.

Shembull:

Numri i nxënësve të larguar nga shkolla	12
Numri i nxënësve të shkollës të regjistruar në fillim të vitit shkollor	607
Përqindja	**1.98**

2. Përqindja e orëve të munguara nga nxënësit, kundrejt të gjitha orëve mësimore të një viti mësimor.

Në përllogaritjen e totalit të mungesave nuk merren në konsideratë mungesat për nxënësit braktisës. Numri i orëve mësimore të një viti shkollor gjendet me këtë mënyrë:

- Gjeni numrin e orëve mësimore javore të çdo klase, sipas planit mësimor, p.sh. të klasës së tetë dhe shumëzojeni me numrin përkatës të javëve të vitit mësimor të asaj klase (32 orë javore x 35 javë mësimore);
- Shuma e dalë shumëzohet me numrin e nxënësve në të gjitha klasat e teta (p.sh 62 nxënës);

[2] Si referencë të merren të dhënat e muajit tetor, të vitit shkollor përkatës.

- Pra, numri i orëve totale të vitit shkollor, për klasat e teta, është: **32x35x62 = 69 440 orë**;
- Mblidhen orët mësimore vjetore të të gjitha klasave të shkollës (për çdo paralele).
- Shuma nxjerr "*Numrin e orëve mësimore të një viti mësimor*".

Shembull:

Numri i orëve të munguara nga të gjithë nxënësit e shkollës	3243
Numri i orëve mësimore të një viti mësimor	257040
Përqindja e orëve të munguara nga nxënësit	**1.26**

3. Përqindja e nxënësve kalues në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë/Maturës Shtetërore.

Numri total i nxënësve kalues, pjesëtohet me numrin total të nxënësve pjesëmarrës në të tri provimet kombëtare dhe tri provimet e detyruara në MSh, dhe shuma e dalë shumëzohet me 100, pra (218 : 231) x 100 = 94.37%.

Shembull:

	Nxënës gjithsej	**Nxënës mbetës**	**Nxënës kalues**	**Përqindja**
Përqindja e nxënësve kalues në gjuhën e huaj	77	3	74	96.10
Përqindja e nxënësve kalues në gjuhën shqipe/gjuhën shqipe dhe letërsi	77	4	73	94.81
Përqindja e nxënësve kalues në lëndën e matematikës	77	6	71	92.21
Përqindja e nxënësve kalues në PKAB/MSh				**94.37**

4. Nota mesatare e shkollës në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë/Maturës Shtetërore.

Shembull:

Provimet sipas lëndëve	**Nota mesatare**
Nota mesatare e shkollës në provimin e gjuhës së huaj	8.81
Nota mesatare e shkollës në provimin e gjuhës shqipe/gjuhës shqipe dhe letërsisë	8.52
Nota mesatare e shkollës në provimin e matematikës	7.94
Nota mesatare në të gjitha provimet	**8.42**

5. **Diferenca ndërmjet notës mesatare të shkollës, në provimet e gjuhës së huaj, të gjuhës shqipe dhe të matematikës, me notën mesatare të këtyre lëndëve, në klasën e 9-të.**

Shembull:

Nr.	Lënda	Nota mesatare në klasën e 9-të	Nota mesatare në PKAB	Diferenca (vlerë absolute)
1	Gjuhë e huaj	8.10	7.81	0.29
2	Gjuhë shqipe	7.80	7.72	0.08
3	Matematikë	7.40	6.90	0.50
	Vlera e treguesit			**0.29**

6. **Diferenca ndërmjet notës mesatare të shkollës në provimet e lëndëve të detyruara, me notën mesatare të këtyre lëndëve, në klasën e 12-të.**

Shembull:

Nr.	Lëndët	Nota mesatare në klasën e 12-të	Nota mesatare në MSh	Diferenca (në vlerë absolute)
1	Gjuhë e huaj	7.50	7.32	0.18
2	Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.30	7.19	0.11
3	Matematikë	6.90	7.02	0.12
	Vlera e treguesit			**0.14**

7. **Përqindja e nxënësve që e kanë diferencën më të madhe se 1 notë (në vlerë absolute) në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë/Maturës Shtetërore.**

Mënyra e përllogaritjes së treguesit:

- Evidentohet numri i nxënësve që e kanë diferencën e notës mesatare vjetore, në secilën prej tri lëndëve: gjuhë e huaj, gjuhë shqipe/gjuhë shqipe dhe letërsi dhe matematikë, me notën mesatare të provimeve në PKAB/MSh (të këtyre lëndëve), më të madhe se 1.
- Ky numër pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të nxënësve që morën pjesë në të gjitha provimet dhe shumëzohet me 100.

Shembull:

Lënda	Numri total i nxënësve pjesëmarrës në provim	Numri i nxënësve me diferencë >1	Përqindja e nxënësve me diferencë >1 (në vlerë absolute)
Gjuhë e huaj	75	5	6.67
Gjuhë shqipe dhe letërsi	75	4	5.33
Matematikë	75	7	9.33
Vlera e treguesit			**7.11**

8. Pikët mesatare në vlerësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor (VANAF).

Ky tregues llogaritet mbështetur në "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin për VANAF-in në vitin shkollor përkatës. Pikët mesatare të nxënësve gjenden, duke pjesëtuar shumën e pikëve të fituara nga nxënësit në test, me numrin e nxënësve që morën pjesë në test.

Shembull:

Totali i pikëve të marra nga nxënësit në test	1016
Numri i nxënësve që morën pjesë në test	21
Pikët mesatare (vlera e treguesit)	**48.38**

9. Përqindja e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët që vijojnë arsimin e mesëm të lartë.

Këtë tregues e plotëson drejtori i shkollës në bashkëpunim me koordinatorin e ZVAP-së.

Shembull:

Numri i nxënësve që u regjistruan në arsimin e mesëm të lartë	23
Numri i nxënësve që mbaruan klasën e 9-të dhe që morën dëftesën e lirimit	24
Përqindja (vlera e treguesit)	**95.83**

10. Realizimi i objektivit (objektivave) të planit vjetor të shkollës.

Objektivi tregon se në çfarë mase do të arrihet synimi gjatë vitit shkollor. Çdo objektiv lidhet me rezultatet e nxënësve, është i matshëm, i krahasueshëm dhe nuk nxit ngritjen fiktive të notave.

Shembull:

Objektivi	Gjendja	Plani	Realizimi	Vlera e treguesit
Të rritet nota mesatare në fushën e matematikës në AMU nga 7,9 të vitit të kaluar në 8,1.	7.9	8.1	8.0 (50%)	**62,50%**
Të rritet nota mesatare e provimeve të lirimit nga 7,7 të vitit të kaluar në 7,9.	7.7	7.9	7.85 (75%)	

Objektivin e parë shkolla e ka realizuar me rritje 0.1 nga 0.2 të planifikuar. Pra, objektivi i parë është realizuar me 50%. Objektivin e dytë shkolla e ka realizuar nga me rritje 0.15 nga 0.2 të planifikuar. Pra, shkolla e ka realizuar objektivin e dytë me 75%.
Vlera e këtij treguesi gjendet me mesatare aritmetike, përkatësisht (50%+75%)/2 = 62.50%.
Rendtitja e shkollave bëhet sipas nivelit të realizimit të objektivave.

11. Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin, (olimpiadat, konkurse, aktivitete) që shpall ministria përgjegjëse e arsimit.

Fitues janë mësues, nxënës ose vetë shkolla që kanë certifikatën nga ministria përgjegjëse e arsimit. Nëse nuk ka asnjë fitues, për këtë tregues vlera është zero.

Shembull:

Në rastin e mëposhtëm, shkolla ka 2 fitues në vendin e dytë dhe 1 fitues në vendin e tretë.
Vlera e treguesit llogaritet:

- Gjendet rezultati si prodhim i pikëve me numrin e fituesve për çdo vend. (7 x 2 = 14 vendi II dhe 4 x 1 = 4 vendi III);
- Mblidhen rezultatet që ka zënë shkolla (14 + 4 = 18). Numri **18** është vlera e treguesit.

Vendi që zë shkolla	Numri i fituesve	Pikët	Rezultati
I	0	10	0
II	2	7	14
III	1	4	4
Vlera e treguesit			**18**

12. Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin (konkurse, aktivitete) që shpallin ZVAP-të.

Fitues janë mësues, nxënës ose vetë shkolla që kanë certifikatën nga ZVAP-ja.
Nëse nuk ka asnjë fitues për këtë tregues vlera është zero.
Numri i vendeve fituese caktohet nga ZVAP-ja, por nuk është më i madh se pesë.

Shembull:

Vlera e treguesit gjendet me këtë mënyrë:

- Shumëzoni "Numri i fituesve" me "Pikët" përkatëse dhe rezultatin vendoseni te kutiza përkatëse te rreshti "Shumëzimet".
- Mblidhni të gjitha rezultatet e shumëzimeve dhe vendosni shumën te kutiza "Gjithsej".

Numri **12** është vlera e këtij treguesi për këtë shkollë.

Vendi	Vendi I	Vendi II	Vendi III	Vendi IV	Vendi V	Vlera e treguesit
Pikët	5	4	3	2	1	
Numri i fituesve	0	1	2	0	2	
Shumëzimet	0	4	6	0	2	**12**

13. Rezultatet e mësuesve të shkollës në provimet e kualifikimit gjatë 4 viteve të fundit shkollore.[3]

Shembull

	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët	Gjithsej	Vlera e treguesit
Numri i mësuesve të kualifikuar.	3	15	7	3	1	29	
Përqindja	10.34%	51.72%	24.14%	10.34%	3.45%	100%	
Pikët	4	3	2	1	0		
Shumëzimet	0.41	1.55	0.48	0.10	0.00	**2.55**	**255**

Numri **255** tregon vlerën e treguesit (Del nga shumëzimi i 2.55 me 100).

[3] Nëse shkolla nuk ka asnjë mësues që i është nënshtruar provimit të kualifikimit, për 4 vitet e fundit, atëherë shkolla vendos rezultatin/rezultatet e mësuesit/mësuesve, për vitin e fundit kur ka pasur.

14. Përqindja e maturantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare për të vijuar studimet në institucionet e arsimit të lartë.

Shembull:

Nota mesatare për vijimin e studimeve në IAL, për vitin akademik 2021-2022 është nota 7.

Numri i maturantëve që plotësojnë kriterin e mesatares për IAL	35
Numri i maturantëve të shkollës	42
Përqindja (vlera e treguesit)	**83.33**

D. PYETËSORËT

Pyetësorët zhvillohen me prindër, mësues dhe nxënës. Qëllimi i këtyre pyetësorëve është që pjesëmarrësit të shprehin mendimin e tyre për ecurinë e shkollës.

Pyetësorët hartohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Për çdo pyetje të pyetësorëve tregohet mënyra e gjetjes së vlerës së saj, në mënyrë që të mundësojë renditjen e shkollave. Modeli kryesor për gjetjen e vlerave të pyetjeve është paraqitur në këtë udhëzues, për përgjigjet me katër alternativa.

ASCAP-i i dërgon pyetësorët ZVAP-së-brenda muajit mars. Para zhvillimit të pyetësorëve, çdo shkollë i dërgon ZVAP-së numrin e nxënësve të çdo paraleleje të klasave V-VIII të arsimit bazë ose X e XI të arsimin e mesëm të lartë. Në çdo vit shkollor, ZVAP-ja përzgjedh me short, klasën në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm, me të cilën do të kryhet pyetësori me nxënësit. Pyetësori do të zhvillohet me nxënësit e të gjitha paraleleve të klasës së përzgjedhur me short.

ZVAP-ja organizon zhvillimin e pyetësorëve dhe përpunimin e tyre. Titullari i ZVAP-së me një urdhër, cakton specialistët përgjegjës për realizimin e pyetësorëve dhe përpunimin e të dhënave të tyre. Kur numri i specialistëve të ZVAP-së është i pamjaftueshëm, titullari i ZVAP-së cakton mësues të luajnë rolin e administratorit. Mësuesi duhet të administrojë një shkollë në të cilën nuk jep mësim. ZVAP-ja përgatit bazën materiale për të tre pyetësorët, të ndara për çdo shkollë.

Çdo pyetësor zhvillohet në të gjitha shkollat në të njëjtën ditë. Pyetësorët, kur është e mundur, mund të zhvillohen online.
Drejtori, nëndrejtori/ët dhe mësuesit e shkollës nuk duhet të jenë të pranishëm në klasat/sallat ku do të zhvillohen pyetësorët me nxënësit apo prindërit. Drejtori i shkollës ka përgjegjësi për të siguruar numrin e duhur të pjesëmarrësve për të tre pyetësorët, si dhe mjediset e përshtatshme.

Administratorët e pyetësorëve kanë përgjegjësinë e zhvillimit korrekt të tyre. Ata duhet t'u shpjegojnë pjesëmarrësve dobishmërinë e pyetësorit në përmirësimin e shërbimit arsimor të ofruar nga shkolla.
Pyetësorët e zhvilluar në çdo shkollë ruhen të paktën një vit shkollor.

Pyetësori me nxënësit

Administratorët zhvillojnë pyetësorët me nxënësit e paraleleve të klasës së përzgjedhur me short, duke ruajtur konfidencialitetin. Ata duhet të jenë sa më të komunikueshëm dhe dashamirës me nxënësit. Ata u shpjegojnë nxënësve qëllimin e pyetësorit dhe rëndësinë që kanë përgjigjet e tyre për të përmirësuar arritjet e shkollës.
Administratorët sqarojnë nxënësit se si do ta plotësojnë pyetësorin. Ata sqarojnë nxënësit se janë të lirë të japin përgjigjet si i mendojnë dhe u sigurojnë atyre ruajtjen e anonimatit.

Pyetësori me prindërit

Në pyetësor duhet të marrin pjesë të paktën 10% e prindërve të nxënësve të shkollës. Kur nuk sigurohet ky prag minimal, pyetësori nuk zhvillohet ose nuk ka vlerë. Në këtë rast, shkolla. që nuk ka arritur të sigurojë numrin e mjaftueshëm të prindërve merr 0 pikë.

Pyetësori me mësuesit

Në pyetësor duhet të marrin pjesë të gjithë mësuesit e shkollës, përveç mësuesve me kontratë pune me afat. Pyetësori zhvillohet në mjediset e shkollës.

F. RENDITJA E SHKOLLAVE NGA ZVAP[4]

Renditja e shkollave për një tregues

- Në vend të parë vendoset shkolla që ka vlerën "më të mirë" të treguesit e pastaj me radhë.
- Kur dy shkolla kanë të njëjtën vlerë të një treguesi, zënë të njëjtin vend në renditje.
- Në treguesit përfshihen edhe përgjigjet e pyetësorëve.

Shembull:

Treguesi: Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla, kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor.

Shkollat	Përqindja	Renditja/Vendi
Shkolla A	1%	2
Shkolla B	1%	2
Shkolla C	0%	1
Shkolla D	4%	3
Shkolla E	5%	4

[4] Bashkëlidhur këtij udhëzuesi, për të thjeshtuar llogaritjet, gjendet tabela me të gjithë treguesit në Excel.

Renditja e shkollave për të gjithë treguesit

- Në tabelën excel, për secilin tregues, vendoset vendi që zë çdo shkollë dhe vlera e treguesit.
- Për secilën shkollë, mblidhen numrat e vendeve që ka zënë ajo për të gjithë treguesit.
- Renditen shkollat për të gjithë treguesit.
- Shkolla me shumën më të vogël të pikëve zë vendin e parë e pastaj kështu me radhë.
- Kur dy shkolla kanë shumë të njëjtë të pikëve, zënë të njëjtin vend.

Shembull:

Treguesit	Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla, kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor	Rezultatet e mësuesve në provimet e kualifikimit gjatë 4 viteve të fundit	Përqindja e maturantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare, për të vijuar studimet në IAL	Shuma e vendeve	Renditja e shkollave
Shkolla A	2 (0.01)	1 (250 pikë)	3 (75%)	6	**2**
Shkolla B	3 (0.03)	3 (242 pikë)	2 (78 %)	8	**3**
Shkolla C	1 (0 %)	2 (245 pikë)	1 (80%)	4	**1**
Shkolla D	4 (0.04)	5 (225 pikë)	4 (70 %	13	**4**
Shkolla E	5 (0.06)	4 (230 pikë)	4 (70 %)	13	**4**

Renditja e shkollave për ndryshimet ndërmjet dy viteve shkollore

KPSh-ja, në vitin pasues shkollor, përmban edhe vendin që zë shkolla, për ndryshimet ndërmjet dy viteve shkollore të njëpasnjëshme, d.m.th., ndërmjet vitit të kaluar shkollor dhe vitit shkollor paraardhës me të. Këto ndryshime njehsohen për të gjithë treguesit. Me këtë mënyrë evidentohen shkollat që nuk janë dalluar për rezultate të larta, por kanë ndryshime pozitive nga viti në vit.

Shembull:

Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla, kundrejt atyre të regjistruar në fillim të vitit shkollor.

Treguesi	Shkolla A	Shkolla B	Shkolla C	Shkolla D	Shkolla E
Viti shkollor paraardhës	1%	1%	0%	4%	5%
Viti i kaluar shkollor	1%	2%	2%	3%	2%
Diferenca	**0%**	**-1%**	**-2%**	**1%**	**3%**
Renditja e shkollave	3	4	5	2	1

Renditja tërësore e shkollave

Renditja tërësore e shkollave përfshin renditjen për vitin e kaluar shkollor dhe renditjen për ndryshimet në dy vitet e njëpasnjëshme.

Shembull:

Treguesi "Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla, kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor".

	Shkolla A	Shkolla B	Shkolla C	Shkolla D	Shkolla E
Renditja në vitin e kaluar shkollor	1	3	3	2	4
Renditja për ndryshimet në dy vitet e njëpasnjëshme	2	4	5	2	1
Shuma e vendeve	3	7	8	4	5
Renditja tërësore e shkollave	**1**	**4**	**5**	**2**	**3**

Renditja e shkollave dhe shpallja e shkollave të suksesshme

Shkolla vendos në faqen e internetit dhe në një vend të dukshëm në mjediset e saj, për nxënësit dhe për prindërit, tabelën e renditjes së shkollës për çdo tregues dhe për treguesit në tërësi.

ZVAP-ja publikon në faqen e saj të internetit dhe e vendos tabelën e përgjithshme të renditjes së shkollave në një vend të dukshëm në mjediset e saj, për nxënësit, prindërit dhe komunitetin. ZVAP-ja shpall shkollat e suksesshme, p.sh., ato që zënë tri ose pesë vendet e para.

Procedurat e hartimit të Kartës janë objekt i monitorimit/vlerësimit/inspektimit nga institucionet përgjegjëse të monitorimit/vlerësimit/inspektimit.

G. DETYRA TË INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË HARTIMIN E KARTËS

Ministria e Arsimit dhe Sporteve:

- miraton treguesit e KPSh-së;
- shpall listën vjetore të treguesve në udhëzimin e vitit të ri shkollor;
- kërkon përditësimin e këtij udhëzuesi kur e gjykon të nevojshëm;
- shpall emrat e shkollave të suksesshme në nivel kombëtar.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar:

- kryen përmirësimin e treguesve të KPSh-së;
- harton pyetësorët që do të zhvillohen me prindërit, mësuesit dhe nxënësit;

- përshkruan mënyrën e gjetjes së vlerës për pyetësorët dhe për treguesit e rinj;
- monitoron plotësimin e KPSh-së në nivel vendor dhe shkolle, si dhe promovon modele të praktikave të suksesshme;
- harton raportin kombëtar të KPSh-së dhe e dërgon në MAS.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar:

- administron databazën e të dhënave të renditjes së shkollave për secilën ZVAP;
- dërgon në ASCAP, databazën e të dhënave të renditjes së shkollave për secilën ZVAP, për hartimin e raportit kombëtar të KPSh-së;
- monitoron plotësimin e KPSh-së në nivel vendor dhe shkolle;
- merr masa për drejtorët e ZVAP-së ku janë vërejtur pasaktësi, në përpunimin e të dhënave të Kartës, pas informacionit të dhënë nga DRAP-i.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar:

- monitoron procesin e plotësimit të KPSh-së në nivel vendor dhe shkolle;
- merr masa për drejtorët e shkollave, ku janë vërejtur pasaktësi në përpunimin e të dhënave të Kartës, sipas propozimit të titullarit të ZVAP-së;
- informon DPAP-në për të gjitha rastet e pasaktësive të gjetura në ZVAP dhe shkolla;
- administron databazën e të dhënave të renditjes së shkollave, sipas ZVAP-ve që ka në juridiksion;
- dërgon në DPAP, databazën e të dhënave të renditjes së shkollave, sipas ZVAP-ve që ka në juridiksion.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar:

- cakton koordinatorin/ët, i cili organizon plotësimin e KPSh-së nga shkollat dhe përpunimin e të dhënave në ZVAP;
- organizon mbledhje me drejtorë dhe nëndrejtorë të shkollave ku i sqaron për detyrat e tyre në plotësimin e KPSh-së;
- cakton me short klasën ku do të zhvillohen pyetësorët me nxënësit e arsimit bazë/të mesëm;
- zhvillon pyetësorët;
- verifikon të dhënat e treguesve të KPSh-së, të dërguara nga shkollat, në veçanti realizimin e objektivit/objektivave të planit vjetor të shkollave;
- propozon masa për drejtorët e shkollave që kanë pasaktësi në plotësimin e KPSh-së;
- rendit shkollat;
- publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, KPSh-të e të gjitha shkollave në juridiksion;
- organizon ceremoninë për shpalljen e shkollave të suksesshme;
- harton raportin e KPSh-së në nivel vendor dhe e dërgon në DRAP, DPAP dhe ASCAP;
- mban përgjegjësi për saktësinë e renditjes së shkollave në nivel vendor.

Drejtori i shkollës:

- siguron numrin e duhur të pjesëmarrësve në të tre pyetësorët, si dhe mjediset e përshtatshme;
- dërgon me shkrim te titullari i ZVAP-së, të dhënat për treguesit e parashikuar në këtë udhëzim, bashkë me datën e dërgimit, firmën e tij dhe vulën e shkollës;
- mban përgjegjësi për plotësimin e saktë të treguesve të KPSH-së;
- mban përgjegjësi për saktësinë e çdo të dhëne që i dërgon ZVAP-së.

H. AFATET E PLOTËSIMIT TË KARTËS

- ZVAP-ja zhvillon pyetësorët gjatë muajit prill dhe përpunon të dhënat e tyre brenda muajit maj.
- Drejtori i shkollës dorëzon te ZVAP-ja, deri më 20 korrik, të dhënat për të gjithë treguesit që janë parashikuar të njehsohen nga vetë shkollat.
- ZVAP-ja verifikon brenda javës së fundit të muajit gusht, saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të dërguara nga shkollat. Verifikimi realizohet për jo më pak se 20% e shkollave në juridiksion. Ato shkolla te të cilat janë verifikuar pasaktësi të të dhënave për tregues të caktuar, marrin zero pikë për atë tregues.
- Shkollat hartojnë KPSh-në javën e parë të muajit shtator.
- Në fund të shtatorit, ZVAP-ja shpall renditjen e shkollave, shkollat e suksesshme, organizon ceremoninë për shkollat e suksesshme, si dhe përcjellë databazën e të dhënave të KPSh-së te DRAP-i përkatës.
- DRAP-i verifikon deri në fund të muajit tetor, saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të dërguara nga ZVAP-të.
- DRAP-i përcjell informacionin në DPAP për të gjitha ZVAP-të të cilat kanë pasaktësi në renditjen e shkollave.

  Gjithashtu, DRAP-i përcjell databazën e të dhënave të renditjes së shkollave, sipas ZVAP-ve që ka në juridiksion në DPAP.
- Brenda javës së parë të muajit nëntor, DPAP-ja përcjellë databazën e të dhënave të KPSh-së për të gjitha shkollat sipas ZVAP-ve përkatëse, te ASCAP-i.
- Brenda muajit dhjetor, ASCAP-i harton raportin kombëtar të KPSh-së.